



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 39/11

Prishtinë, më 02.12.2011, ora 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Sali Asllanaj, Hykmete Bajrami, Latif Gashi, Muhamet Mustafa, Duda Balje, Xhevdet Neziraj dhe Hasime Krasniqi.

Mungoi: Albana Fetoshi.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Bedri Hamza, Ministër i Financave, Agim Krasniqi Drejtor i Departamentit të Buxhetit në MF, Rejhane Zylfijaj, Ramadan Islami dhe Juergen Schatz-GIZ, monitorues nga KDI dhe OSCE.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli dhe Njomza Halilaj (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e komisionit, datë 25.11.2011**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit (pjesa tekstuale) të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2012; I ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-78 për sigurinë e përgjithshme të produkteve, me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
5. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;**
6. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-70 për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion;**
7. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-40 për rregullimin e tokës me raportin me amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor;**
8. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, hapi mbledhjen dhe propozoi rendin e ditës.

Rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e komisionit më datë 25.11.2011

Procesverbali miratohet pa vërejtje

3. Shqyrtimi i Projektligjit pjesa tekstuale e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2012

Muhamet Mustafa, pyeti se cilat janë ndryshimet esenciale në përmbajtje në krahasim me vitin e kaluar?

Agim Krasniqi, sqaroi se neni 5 që ka të bëjë me të hyrat vetanake të organizatave buxhetore të nivelit qendror ka ndryshuar në krahasim me vitin e kaluar, pasi që për herë të parë të hyrat e nivelit qendror janë pjesë e tabelave të buxhetit. Marrëveshja me FMN-në është që pavarësisht asaj se sa realizojnë të hyra këto organizata, maksimumi i ndarjeve buxhetore është 20 milion € dhe kjo është bërë me arsyen e ruajtjes së totalit të shpenzimeve. Prandaj, në pjesën tabelare dhe atë tekstuale janë të përcaktuar dy burimet e financimit për këto organizata e që janë grantet dhe të hyrat vetanake. Te neni 16 duhet të bëhen disa rregullime. Do të propozohen edhe dy nene të reja që kanë të bëjnë me marrëveshjet që janë arritur me FMN-në dhe partnerët e tjerë. Një amendament do të sigurojë derisa nuk do të ndodhë privatizimi që paraqet një mosalokim prej 60 milion € dhe tjetri ka të bëjë me ndarjen e një fondi nga bilanci bankar për ruajtjen e likuiditetit të sistemit bankar.

Kryetarja, kërkoi sqarime nga drejtori i buxhetit për Nenin 3, pasi që në krahasim me vitin e kaluar është bërë ndarja në tri paragrafi, mirëpo dy paragrafët e fundit janë paksa të pakuptimtë.

Agim Krasniqi, sqaroi se paragrafi 2 ka për qëllim raportimin nga Ministri së paku dy herë në vit, ndërsa te paragrafi 3 duhet të shtohet fjala “në çdo kohë”.

Latif Gashi, theksoi që në paragrafin 2 duhet të bëhet një harmonizim, ndërsa paragrafi 3 i jep mundësi Kuvendit të Kosovës në çdo kohë kur ai kërkon nga Ministria të raportojë.

Muhamet Mustafa, propozoi që në paragrafin 3 të parashihet edhe prezantimi para Komisionit për Buxhet dhe Financa nga ana e Ministrit për raportin gjithëpërfshirës që ka të bëjë me të gjitha ndarjet buxhetore me qëllim që të fuqizohet roli i komisionit në këtë ligj.

Latif Gashi, theksoi që komisioni është pjesë e Kuvendit dhe nënkuptohet që me kërkesë të komisionit Ministri prezanton para Kuvendit.

Komisioni njëzëri miratoi paragrafin 1 dhe 3 të Nenit 3, ndërsa paragrafi 2 mbetet të riformulohet nga Ministria.

Kryetarja, lidhur me Nenin 6 theksoi që nuk ka ndryshime nga viti kaluar, përveç që është shtuar paragrafi 7 dhe janë dy rekomandime të GIZ-së.

Latif Gashi, sqaroi se këto rekomandime kanë të bëjnë me përmirësimin e këndvështrimit të raportit të progresit dhe për këtë pyeti nëse ka Ministria e Financave kapacitete të mjaftueshme për t'i përfshirë këto rekomandime?

Agim Krasniqi, theksoi se nuk ka nevojë të raportohet për diçka ndaras, kur ajo është pjesë e raportimeve të përgjithshme. Esenca e këtyre e rekomandimeve është që të tregohen se çfarë masa do të ndërmerren nëse ndodhë që ndonjë organizatë buxhetore e cila është planifikuar me buxhet të financohet nga të hyrat vetanake, mirëpo përkohësisht financohet nga grantet, atëherë si do të sigurohet shpenzimi i atyre të hyrave.

Juergen Schatz, sqaroi se këto rekomandime dhe propozime e GIZ, janë bërë me qëllim të rritjes së transparencës gjatë ekzekutimit të buxhetit dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa të ketë ndikim dhe informata më të hollësishme për ekzekutimin e buxhetit.

Hasime Krasniqi, përkrahu këto rekomandime, për faktin që kanë të bëjnë me rritjen e transparencës, mirëpo ka nevojë për riformulim, pasi që në shikim të parë duken paksa të paqarta.

Latif Gashi, propozoi që t'i jepet kohë Ministrisë së Financave për riformulim dhe të shqyrtohet në mbledhjen e radhës.

Komisioni njëzëri vendosi që të shtohet pika 5 opsioni i parë i GIZ-së, mirëpo të riformulohet në aspektin gjuhësor dhe teknik nga Ministria e Financave.

Komisioni njëzëri vendosi që në fund të paragrafit 7 të Nenit 6 të shtohet fjalia si në vijim: “Ministri menjëherë njofton Kuvendin-Komisionin për Buxhet dhe Financa, për çdo ndarje shtesë buxhetore për AKP-në.”

Kryetarja, theksoi që ka një rekomandim nga GIZ-ja lidhur me paragrafin 2 të Nenit 7.

Agim Krasniqi, theksoi që paragrafi 2 është i qartësuar dhe nuk ka nevojë për ndryshime.

Latif Gashi, u pajtua me parafolësin dhe propozoi që në këtë paragraf mos të ndërhyhet pasi që është i rregulluar mirë.

Muhamet Mustafa, propozoi që në paragrafin 2 në rreshtin e katërt pas fjalës “obligimet e pakryera” të shtohet fjala “nga viti paraprak”.

Kryetarja, propozoi që në rreshtin e dytë të paragrafit 2 pas fjalës “në Kuvend” të shtohet fjala “për informim”, pasi që ka probleme lidhur raportet që dorëzohen duke mos e ditur se a janë për informim, shqyrtim apo miratim.

Komisioni njëzëri miratoi ndryshimet e bëra në paragrafin 2 të Nenit 7.

Kryetarja, njoftoi që në paragrafin 7 të Nenit 10 është një propozim nga GIZ-ja që të shtohet fjalia si një vijim: “Ministri informon Kuvendin para se të bëhet shpenzimet që kanë të bëjnë me shpronësimin”

Naser Osmani, e konsideroi të panevojshme, për shkak se pas vendimit të Qeverisë dhe pasi të bëhet shpronësimi del në Gazetën Zyrtare dhe kjo është procedurë e rregulluar me ligj.

Latif Gashi, përkrahu mendimin e parafolësit, pasi që ato publikohen në Gazetën e Zyrtare dhe çështja e shpronësimit është e rregulluar me ligj të veçantë dhe më tepër është çështje e Gjykatave.

Muhamet Mustafa, theksoi dallimet në mes të dy opsioneve, pasi që opsioni i parë ka të bëjë vetëm me informim, ndërsa opsioni i dytë ka të bëjë me miratimin e këtyre shpenzimeve në Kuvend.

Bedri Hamza, theksoi se Ligji për Shpronësim është mjaft i qartë duke specifikuar organin iniciues, shpronësues dhe vlerësues. Prandaj çdo ndërhyrje mund të shkaktojë pengesa në kryerjen e punëve.

Sali Asllanaj, theksoi që shpenzimet për shpronësimin janë si të gjitha shpenzimet tjera për të cilat raportohet në mënyrë të njëjtë. Kjo mund të jetë më tepër si përmbushje e standardit të raportit të progresit, sepse përndryshe nuk ka logjikë.

Komisioni njëzëri vendosi që në paragrafin 1 të Nenit 10, fjala “do” të zëvendësohet me fjalën “mund”.

Komisioni njëzëri vendosi që në paragrafin 2 të Nenit 11, fjalët “aprovimit nga Komiteti” të zëvendësohen me fjalët “rekomandimet nga Komisioni”.

Kryetarja, sqaroi se në fund të paragrafit 2 të Nenit 12 është një rekomandim nga GIZ-ja që ka të bëjë me raportimin e Ministrit çdo tre muaj në Kuvend për transferet nga programi i shpenzimeve të paparashikuara në programet tjera, mirëpo kjo çështje është e rregulluar me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Muhamet Mustafa, përkrahu propozimin e GIZ-së, pasi që me këtë ligj po obligohet se çfarë strukture do të ketë raporti, që do të thotë se në raport do të përfshihen edhe të dhënat për transferet e shpenzimeve të paparashikuara.

Latif Gashi, theksoi që kjo ka të bëjë me shpenzimet e paparashikuara po që janë të justifikueshme dhe nuk ka nevojë të kërkohet aprovim.

Agim Krasniqi, propozoi që në Nenin 12, pas paragrafit 3 të shtohet edhe një paragraf i ri 4, i cili ka të bëjë me fondet për shpenzimet kontingjente që janë pjesë e tabelës për Rezervën Komunale për Komunitetet e Reja nën Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe duhet të rregullohet se si do të bëhet shpenzimi i tyre.

Komisioni njëzëri vendosi që pas paragrafit 3 të Nenit 12 të shtohet paragrafi i ri 4, që do të propozohet nga Ministria e Financave.

Kryetarja, sqaroi që në paragrafin 5 të Nenit 13 është një propozim nga GIZ-ja që të shtohet në fund të paragrafit edhe fjalia “dhe informim të menjëhershëm të Komisionit për Buxhet dhe Financa të Kuvendit nga ana e Ministrit”.

Latif Gashi, theksoi që Ministria e Financave nuk ka kapacitete për t'i kryer të gjitha procedurat administrative dhe për të cilën nevojitet të ndahet buxhet shtesë për të angazhuar ekspertë për këto punë.

Sali Asllanaj, nuk e konsideroi mungesën e kapaciteteve si justifikim për këtë çështje, por arsyja qëndron në atë se sa është e nevojshme të bëhet ky informim.

Naser Osmani, theksoi që edhe në planin e punës së komisionit janë paraparë rastet kur Ministri duhet të japë llogari para komisionit, mirëpo këto informata nuk janë kompetencë e Kuvendit dhe komisionit dhe janë të panevojshme.

Bedri Hamza, sqaroi se kjo ka të bëjë me rastin kur një komunë mund të ketë brenda programit të administratës tepriçë të pagave, përderisa brenda programit të drejtorisë së urbanizmit mund të ketë mungesë. Kjo ka të bëjë me transferimin e mjeteve prej një programi në programin tjetër brenda së njëjtës organizatë buxhetore dhe kjo është pjesë e raportimeve tremujore.

Komisioni njëzëri miratoi ndryshimet e propozuara në Nenin 13.

Juergen Schatz, sqaroi lidhur me Nenin 14 se kur bëhen ndryshime në lidhje me atë që është aprovuar atëherë komisioni duhet ta ketë të drejtën për tu informuar lidhur me ato ndryshime, përderisa në projektligj informimi i vetëm i komisionit parashihet në paragrafin 3 atëherë kur ka ndryshime në projektet kapitale mbi 25%. Mirëpo, edhe kur ka ndryshime për projekte nën vlerën 25%, prapë mund të jetë një shumë e madhe dhe Kuvendi duhet të informohet për këtë gjë. Këto informata janë të njohura për Ministrinë e Financave dhe duhet të përfshihen në raportet tremujore.

Bedri Hamza, sqaroi se Neni 14 është në harmoni të plotë me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe nuk ka nevojë të ndryshohet.

Muhamet Mustafa, nuk u pajtua me atë se nëse ndërhyrja në këtë nen do të reflektojë ndryshime edhe në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, pasi që kjo ka të bëjë me një transparencë më të mirë të shpenzimeve për projektet kapitale dhe nuk kërkon aprovim nga komisioni, por vetëm raportim.

Agim Krasniqi, sqaroi që pjesë e raportimeve tremujore është edhe raporti që bëhet për projektet individuale kapitale duke përfshirë të gjitha ndryshimet në këto projekte.

Latif Gashi, sqaroi se paragrafi 3 i Nenit 14 e rregullon shumë mirë këtë çështje dhe siguron një transparencë të duhur.

Hasime Krasniqi, falenderoi GIZ-në për kontributin e tyre, mirëpo ajo çka ata kanë rekomanduar është duke u aplikuar momentalisht.

Komisioni njëzëri vendosi që Neni 16 të ndryshohet dhe të jetë siq ka qenë vitin e kaluar duke shtuar edhe një paragraf të ri 3, sipas së cilit sponzoruesi i një projektligji duhet harmonizojë qëndrimet me Ministrinë e Financave, lidhur me ndikimet buxhetore të projektligjit, para dorëzimit të tij në Qeveri dhe Kuvend, për shqyrtim dhe miratim.

Bedri Hamza, njoftoi anëtarët e komisionit që Qeveria i ka propozuar dy nene pas nenit 17, të cilat janë pjesë e marrëveshjes dhe kërkesë e FMN-së. Njëri nen është pjesë e tabelës 1 që ka të bëjë me fondet për ruajtjen e asistencës emergjente për likuiditet dhe FMN-ja kërkon që të përfshihet kjo edhe në pjesën tekstuale, ndërsa neni tjetër kërkon që 60 milion € të mbesin të paalokuara gjatë gjithë vitit të ardhshëm fiskal deri në momentin e shpalljes së fituesit të PTK-së.

Komisioni njëzëri miratoi propozimet e MF, për shtimin e dy neneve të reja, Neni 18 dhe Neni 19. Komisioni njëzëri vendosi që Neni 19 të riformulohet si në vijim: “Ky ligj hyn në fuqi më 1 Janar 2012”.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

PËRFUNDIM

I. Miratohen ndryshimet e bëra në nenin 3 paragrafi 3, nenin 6 paragrafi 5 dhe 7, nenin 7 paragrafi 2, nenin 10 paragrafi 1, nenin 11 paragrafi 2, nenin 16 dhe miratohet propozimin e Ministrisë së Financave për shtimin e dy nene të reja neni 18 dhe neni 19.

II. Ndryshimet e miratuar në parim në nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 12 paragrafi i ri 4, do të votohen në një mbledhje tjetër të Komisionit, pas prezantimit të tekstit nga Ministria e Financave.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve me raportin me amendamente të komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe raportin me amendamente të komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Kryetarja, theksoi që sipas Departamentit të Buxhetit ky ligj është i përballueshëm, pasi që mund të implementohet brenda kufirit të shpenzimeve për vitin 2011 dhe Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2012-2014.

Naser Osmani, ngriti çështjen e Bordeve, pasi që edhe ky agjencion duhet ta ketë të rregulluar menaxhimin e Bordeve, sikurse të gjitha agjencionet tjera të pavarura. Nuk ka mundësi që kryetari dhe nënkryetarët të jenë me orar të plotë në Bord, për shkak se nëse ata veprojnë me orar të plotë, atëherë kjo i shndërron ata në shërbyes civil si dhe vihet në pikëpyetje edhe roli dhe detyra e Kryeshefit Ekzekutiv. Si rezultat kjo çështje ose duhet të refuzohet ose duhet të riformulohet.

Latif Gashi, theksoi që ky është Komision i Pavarur i Mediave dhe dallon prej agjencioneve tjera të pavarura, kështu që nuk ka nevojë për ndryshime, sepse kjo është përkrahur nga shumica e përfaqësuesve të mediave.

Naser Osmani, kundërshtoi këtë çështje, sepse mediat nuk bëjnë ligje, por deputetët. Po ashtu, kjo paraqet një përzierje të kompetencave të menaxhmentit. Propozoi që në Nenin 12 te pika 3 të fshihet fjalia “me orar të plotë të punës”.

Sali Asllanaj, i konsideroi arsyetimet e parafolësit, për fshirjen e tekstit “me orar të plotë të punës”, të arsyetuara dhe gjithashtu propozoi që të fshihet kjo pjesë.

Latif Gashi, u pajtua me anëtarët që të bëhet ndryshimi, mirëpo pyeti se cilat janë kompetencat e Komisionit për Buxhet dhe Financa që ta ndryshojë këtë çështje, përderisa komisionet tjera e kanë përkrahur e gjithashtu edhe ICO-ja. Propozoi që të shtyhet kjo pikë për një mbledhje tjetër dhe të merren sqarime lidhur me këtë çështje.

Xhevdet Neziraj, propozoi që kjo pikë të shtyhet për tu sqaruar me komisionin funksional më hollësisht.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

PËRFUNDIM

Komisioni njëzëri vendosi që kjo pikë të shtyhet për një mbledhje tjetër të Komisionit.

6. Shqyrtimi Projektligjit nr. 04/L-70 për Dhënien e Dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës me raportin me amendamente të komisionit funksional për Legjislacion

Kryetarja, theksoi që Projektligji nuk përmban implikime buxhetore, mirëpo në Nenin 15 parashihet të formohet një njësi për dhënien e dekoratave që nënkupton edhe staf shtesë, përderisa ekziston në kuadër të presidencës një zyrtar, i cili merret me punët teknike për këtë çështje. Propozoi që të fshihet fjala “njësia”, në mënyrë që të mos ketë implikime buxhetore lidhur me të punësuarit që do të nevojiten për këtë njësi.

Sipas propozimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 04/L-70 për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës, nuk përmban implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të nenit 15.

Amendamenti 1

Neni 15, në titullin e këtij neni, të fshihet fjala “Njësia”.

Në paragrafin 1, të fshihet fjala “Njësia” dhe “sekretari”. Ndërsa në paragrafin 2, paragrafin 3 dhe paragrafin 4, të fshihet fjala “Njësia”.

2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional për Legjislacion për Projektligjin nr. 04/L-70 për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-40 për Rregullimin e Tokës me raportin me amendamente të komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

REKOMANDIM

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

8. Të ndryshme

Nuk pati ndonjë çështje tjetër për të diskutuar

Mbledhja përfundoi në orën 13:40

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

**Kryetarja e Komisionit
Safete Hadërgjonaj**